

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kurbani i fundit për Kosovën/ Drejtësia e lupës politike dhe dora e historisë
ADRESA	https://www.cna.al/opinione/kurbani-i-fundit-per-kosoven-drejtesia-e-lupes-politike-dhe-dora-e-hist-i474323
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 11:45:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 11:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1693da77a1140edc6c30b1dfcb704ac7c893e17e5fa23b36c6edec15debe20ec
TEKSTI	3f0f3596eb630364fba62543f94090d408bc770143fa17169e8fe427c8ccf8be
PAMJA	cda4b8ebbe1ca38026deb3cc369cbf244074419040c7659b79b0fe3eb91bf9d3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dcd341555c0ee9cab9163f2e1f93a30fe816ecc1375ac03e76e0f62537c6d346
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	06975047e5a3601e37e96e97bfab995ceed02fbc2c1535a000f7cb9180af2b1a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/dcd341555c0ee9cab9163f2e1f93a30fe816ecc1375ac03e76e0f62537c6d346>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

13:28 Aktualitet

Prej disa muajsh ka lindur një përplasje midis ekzekutivit...

Kurbani i fundit për Kosovën/ Drejtësia e lupës politike dhe dora e historisë



16 Shtator 2026, 13:25, Opinione Lutfi Dervishi



Kur Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi morën armët për çlirimin e Kosovës, vështirë se ndonjëri prej tyre ishte i sigurtë se do të kthehej gjallë në shtëpi.

Në atë kohë në Kosovë nuk mendonte kush se çfarë do të bëhej pas 25 apo tridhjetë vjetësh sepse pyetja e ditës ishte: a do të jemi nesër gjallë?

Sot, gati tri dekada më vonë, katër prej drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dëgjuan në Hagë verdiktin e një gjykate politiko-gjoja ligjore të krijuar posaçërisht për krimet e pretenduara të pjesëtarëve të UÇK-së.

Hashim Thaçi u dënua me 25 vjet burg. Për një burrë 58-vjeçar, është pothuajse pjesa tjetër e jetës.

Lufta nuk është film ku një regjisor cakton të mirët dhe të këqijtë, skenat, dialogët dhe fundin. Lufta nuk është klinikisht e pastër aq më tepër dhe veçanërisht kur është një luftë e imponuar dhe shqiptarët vetëm luftuan për vetëmbrojtje. Nuk besoj se ka luftë ku çdo veprim është i ligjshëm.

Sigurisht që çdo viktimitë meriton drejtësi, dhe asnjë luftë, sado e drejtë të jetë kauza e saj, nuk të jep imunitet për krime.

Por drejtësia, si asgjë, nuk zhvillohet në vakuum. Ajo ka kontekst. Konteksti quhet Jugosllavi dhe shpërbërja e përgjakshme e saj. Konteksti quhet Bosnjë, Srebrenicë, pastrim etnik, vrasje dhe dëbim masiv i shqiptarëve të Kosovës nga trojet e tyre.

Konteksti janë kolonat e refugjatëve, fshatrat e djegura, varret masive, viktimat ende pa varr.

UÇK-ja nuk hyri në territorin e Serbisë për të pushtuar Beogradin, ajo luftoi në Kosovë, për Kosovën dhe për popullin e saj.

Bota demokratike e asaj kohe nuk qëndroi neutrale ndaj pastrimit etnik që po ndodhte para syve të saj. NATO ndërhyri ushtarakisht në vitin 1999 duke bombarduar Beogradin dhe pas luftës, Kosova kaloi nën administrim ndërkombëtar. Më 2008 Hashim Thaçi i dënua sot me 25 vjet burg, (vetë drejtësia serbe e kishte dënua 10 vjet në mungesë më 2005), shpalli vendimin e parlamentit të Kosovës për pavarësi. Kosova sot është shteti më i ri i kontinentit. Ky është konteksti që asnjë vendim gjykate nuk mund ta fshijë.

Vendimi i sotëm mund të debatohet dhe duhet të debatohet, por historikisht dhe në kontekst ai jep një pamje të shëmtuar.

Drejtësia politiko-juridike i ka ngulur një thikë në shpinë drejtësisë historike. Kur drejtuesit e një lëvizjeje çlirimtare marrin dënime që praktikisht mund t'i mbajnë në burg gjithë jetën, lind pyetja nëse drejtësia po gjykon vetëm përgjegjësinë individuale apo, në perceptimin e një populli të tërë, po vendos në bankën e të akuzuarve edhe vetë luftën.

Kjo është arsyeja pse në Kosovë dhe jo vetëm në Kosovë, seanca e sotme nuk u përjetua si proces penal, por po përjetohet si një plagë historike politike.

Një gazetare që ndodhej në sallë e përshkroi atmosferën pas shqiptimit të vendimit vetëm me një fjalë: "Varrim". Ndoshta është fjala më e saktë për atë çast.

Për familjarët dënimet janë të përjetshme. Sot, bashkëluftëtarët nuk panë vetëm katër të dënua në sallën e gjyqit, panë katër njerëz me të cilët, dikur, kishin hyrë në një luftë pa e ditur se çfarë do të sillte e nesërmja.

Kosova sot nuk pa katër të pandehur në bankën e akuzës, por pa katër emra të historisë së saj që dënohen se luftuan për vetëmbrojtje!

Fati e solli që të katër i mbijetuan luftës, e panë Kosovën të çliruar, panë flamurin e saj, panë shpalljen e Pavarësisë. Hashim Thaçi e lexoi deklaratën e pavarësisë si Kryeministër i Kosovës dhe më vonë u bë President i Republikës deri një ditë nëntori të 2020, kur u nis drejt Hagës. Ai nuk u arrestua në ndonjë bodrum, nuk u kap në arrati, por dha dorëheqjen nga posti i Presidentit dhe u paraqiti para drejtësisë.

Që prej atëherë kanë kaluar pothuajse gjashtë vjet paraburgim dhe sot erdhi verdikti.

Mund të diskutojmë pafundësisht për gjithçka, për standardet e provës, përgjegjësinë komanduese, ndërmarrjen e përbashkët kriminale, dëshmitarët dhe çdo paragraf të vendimit, vërtetësia e informacioneve që u janë dërguar prokurorëve, por një gjë nuk mund ta vendosë asnjë trupë gjykuese: nuk mund të vendosë se çfarë ishte UÇK-ja për historinë e Kosovës.

Këtë verdikt historia e ka dhënë më herët. Kosova është e lirë dhe sot Kosova është shtet. Dhe ata të katërt luftuan për këtë shtet.

Nuk mund ta shkëpusësh vitin 1998 nga ajo që kishte ndodhur më parë dhe nga ajo që ndodhi më pas. Nuk mund ta marrësh një copë të luftës, ta vendosësh nën mikroskop dhe të sillësh sikur pjesa tjetër e historisë nuk ekziston.

Afroje lupën mbi dorën tënde. Sa më shumë ta zmadhosh, aq më shumë do të shohësh rrudha, njolla, pore, shenja dhe papërsosmëri. Po ta shohësh vetëm përmes lupës, mund të arrish në përfundimin se ke një dorë të shëmtuar dhe se do të ishte më mirë të kishe një tjetër.


Por hiqe lupën dhe sheh se është dora jote.

Nëse vendos nën lupë vetëm një fragment të një lufte, do të gesh patjetër plagë, gabime, padrejtësi, madje edhe krime. Ato duhen hetuar dhe gjykuar. Por lupa nuk mund të zëvendësojë pamjen e plotë. Një luftë nuk kuptohet vetëm duke numëruar njollat e zmadhuara. Duhet të largosh lupën dhe të pyesësh edhe: pse nisi, kush e imponoi, çfarë po ndodhte me një popull dhe çfarë solli ajo luftë në fund. Lupa mund të të tregojë çdo shenjë të dorës, por nuk mund të të tregojë çfarë ka bërë ajo dorë.

Ndoshta ndonjëri prej të katërve, pas dënimeve të sotme, rrezikon të mos kthehet më i gjallë në shtëpinë prej së cilës doli dikur për luftë. Por një vendim gjykate mund të mbajë dikë në burg, por nuk burgos dot kontributin e tij.

Misioni për të cilin ata të katërt morën armët është kryer. Kosova sot është shtet.

Katër të dënuarit e sotëm mund të shihen nga shumëkush si kurbani i fundit i një lufte që nisi me njerëz të gatshëm të jepnin jetën për një shtet që të gjithë e shihnin në ëndërr.





Të sugjeruara

[Tirana pa kokë dhe medikamenti i kryeministrit](#)

[Dy fjalë të fundit për histerinë folklorike kundër ngritjes së Muzeut Hebraik në Vlorë](#)

[Ekspertët zbulojnë shtatë sjellje të çuditshme që mund të lidhen me inteligjencën e lartë](#)

[Dëgjimet komuniste të Ramës për Reformën Territoriale](#)

[Keqkuptimi me takimet e së premtës!](#)

Jo kundër Muzeut Hebraik në Vlorë, por kundër histerisë rreth tij

Kush është Ron Yeffet dhe çfarë pushteti ka në Shqipëri?

GJYSH, TË FALËM!

"Timak Defence", para se të kërcënoni median, tregoni se çfarë bëni

Azem Hajdari

Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare

Nga zv/ministër i guriçkave në dallkauk, haxhiqamilist

Një propozim modest për protestuesit

FEMINIZMI SI ALIBI

Përpara pasqyrës apo iluzionit mashtrues?

Lajmi është që Ukraina i blen makinat dhe armët me tendera!

Shqipëria në shitje dhe Masakra e Koplikut si tradhti kombëtare

Inteligjenca Artificiale dhe teknologjia tek fëmijët

Prania Besnike e Zeqinesë!


Bilanci njëvjeçar i Diellës


[editorial](#)

13:52 Editorial Elvi FUNDO

Erion Veliaj nuk i lë prokurorisë asnjë mundësi për ta harruar

CNA LIVESTREAM





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.